



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-110-57213

Më datë 31.08.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 5 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, e konform nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit

1. Formohet komisioni për hartimin e projekt- Plani për Integritet për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027 në këtë përbërje:

- 1.1 Avni BYTYÇI-----kryesues
- 1.2 Kymete BAJRAKTARI-----anëtare
- 1.3 Rinor ZYRAPI-----anëtar

2. Detyrë e komisionit është që ta hartojnë projekt- Plani për Integritet për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027 dhe ti rekomandojnë Kryetarit të Komunës për vazhdim të procedurave të mëtutjeshme.

3. **AUTORIZOHET**-komisioni i lartë cekur që të punojnë jashtë orarit të punës dhe ditëve të vikendit për hartimin e projekt- Plani për Integritet për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027.

4. Komisioni për punën jashtë orarit të punës do të kompozohet sipas Ligjit dhe akteve tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës që e rregullojnë këtë çështje.

5. Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ